

LASGUSH PORADECI

## **Baladë**

(NË FYRMË POPULLORE)  
(nga vëllimi "Vallja e yjeve")

### I

Fryn veriu në Mal të Thatë,  
Thotë vasha lele ngriva.

Duro, vashë, të durojmë  
Si duron mali dëborën.

Në të shtëna, moj, në dorë,  
Do të ngroh si top dëborë.

### II

Fryn një erë-e shkundërmuar,  
Thotë vasha çeli molla.

Çeli, vashë, le të çelë,  
Si çel malli mun në zemër.

Në ma dhënç, moj, bel' e hollë,  
Do ta thyej si mënjollë,  
Do të shtrydh posi një mollë.

### III

Vjen e bën një vap' e rëndë,  
Thotë vasha bubu plasa.  
Duro, vashë, të durojmë,  
Si duron kallir' i pjekur.

Në më ardhç, o moj, në hije,  
Do t'i puth për dhemshurie,  
Do t'i skuq t'i ndez qirie,  
Do t'i nxi t'i bëj mavië,  
Ato buzë gjak-qershie.

### IV

Zun' e shkojnë dellëndyshet,  
Thotë vasha po venitem.

Venitu, vashë, venitu,  
Siç venitet zemra ime.

Në të marça, moj, përherë,  
Do të shtroj të parën herë,  
Do të ngroh të dytën herë  
Do të puth të tretën herë  
Buzë e gushë e gjinë e mjerë  
Dh'atë shtatin që mban erë  
Posi luleja në verë  
Gjersa gjumi të m'të zerë,  
Të m'të zerë-e të m'të flerë  
Syr' i urtë si mëshqerrë.

## V

Vate dimri, vate vera,  
Vate vjeshta përngahera.

Trim, më more-edhe më shtrove,  
Trim, më ngrove-e më pushtove,  
Trim, më puthe-e më mbarove,  
Trim, o trim, seç trimërove!

## VI

Atje lart në Mal' të Thatë,  
Zoti-Krisht bëke një kishë.

N'atë kishë ç'paske brënda:  
Qenke trimi edhe vasha:

Trimi, ç'paske dhëndëruar,  
Vasha ç'paske nusëruar,  
Zotin ç'paskan lavdëruar,  
Jetën ç'paskan trashëguar,  
Shpirtin ç'paskan shentëruar.<sup>1</sup>



---

<sup>1</sup> Në pjesën e fundit të këngës popullore, ku u mbështet poeti për krijimin e kësaj poezie, trimi me vashën ikin fshehurazi nga fshati dhe shkojnë në një kishë të vogël në mal për të vënë kurorë. Mirëpo kisha s'e pranon lidhjen e tyre. Dera e saj mbyllet dhe ata plasën në prag të saj. Poeti kërkon ta ligjërojë këtë lidhje shpirtërore të të rinjve dhe kështu e ndryshoi krejtësisht fundin e saj.